
UDHËZIME PËR ZBATIMIN E NENIT 2.8. TË KODIT TË ETIKËS SË GAZETARËVE TË MALIT TË ZI

Ky dokument është produkt i punës së Grupit punës teknik për vetë-regullim, i mbështetur nga misioni i OSBE-së në Mal të Zi



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission to Montenegro

Autorët:

Anëtarët e Grupit punues teknik për vetë-regullim:

Jovićević Ilija

Ombudsman i gazetës ditore Dan,n

Jovović Mihailo

Drejtor programor i së përditshmës së pavarur “Vijesti”

Petričević Paula

Ombudsmane e së përditshmës së pavarur “Vijesti”, dhe javores “Monitor”

Spaić Aneta

anëtare e Komisionit për monitorim dhe ankesa e Këshillit të mediave për vetë-regullim

Vojičić Branko

anëtar i Komisionit për monitorim dhe ankesa i Këshillit të mediave për vetë-regullim

Vujović Ranko

Sekretar ekzekutiv i Këshillit të mediave për vetë-regullim

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E NENIT 2.8. TË KODIT TË ETIKËS SË GAZETARËVE TË MALIT TË ZI

“Mediat online duhet t’i përkufizojnë rregullat e tyre të brendshme lidhur me komentet e personave të tretë. Këto rregulla duhet të kenë për qëllim shmangien e përmbajtjeve të paligjshme dhe joetike, duke respektuar plotësisht lirinë e shprehjes. Komentuesit duhet të njihen me këto rregulla. Komentet në portale i moderon administratori, në bazë të rregullave të përcaktuara.”

Kodi i Etikës së Gazetarëve të Malit të Zi

Udhëzimi 2.8.

SADRŽAJ

PREAMBULA	5
1 Kriteret e komentimit	5
2 Llojet e moderimit	6
3 Procedurat	6
3.1. Regjistrimi.....	6
3.2 Filtrimi i automatizuar.....	6
3.3 Paraqitja e shkeljeve të rregullave të komentimit online .	6
4 Sanksionet	7
4.1. Fshirja e komenteve.....	7
4.2. Ndalimi i përkohshëm i publikimit të komenteve.....	7
4.3. Ndalimi i përhershëm i publikimit të komenteve.....	7

PREAMBULA

Këto rregulla duhet të mundësojnë debat të argumentuar mirë dhe argëtues që respekton dinjitetin e të gjithë pjesëmarrësve dhe kontribuon në diskutimin e temës që ka hapur artikulli.

Këto rregulla janë vendosur për të mbrojtur përdoruesit dhe mediat nga shkelja e normave ligjore dhe etike. Çdo shkelje e rregullave i nënshtrohet sanksionimit.

- 1) Postimi i komenteve - çfarë lejohet dhe çfarë nuk lejohet
- 2) Llojet e moderimit - para ose pas moderimi ose qasje e kombinuar
- 3) Procedurat
- 4) Sanksionet

1 Kriteret e komentimit

- 1.1. Komentet nuk duhet të përmbajnë gjuhë të urrejtjes¹ ose të jenë diskriminuese, as të kenë përmbajtje tjera të paligjshme: kërcënime, propagandim dhe thirrje për dhunë, nxitje të çfarëdo lloji të krimit kibernetik², cenim të të drejtave të autorit mbi pronën intelektuale, akuza qartësisht të pabaza etj.
- 1.2. Komentet nuk duhet të përmbajnë gjuhë fyese.

Me gjuhë fyese nënkuptohet sulmi i paarsyeshëm personal ndaj dikujt që nuk kontribuon në diskutim të interesit publik.
- 1.3. Komentari ne smiju da sadrže psovke i vulgarne izraze koji vrijeđaju javni moral.
- 1.4. Komentet nuk duhet të përmbajnë materiale reklamuese ose promovuese, përfshirë edhe linqe që kanë të bëjnë me: faqe personale interneti dhe forume, hulumtime dhe pyetësorë, faqe interneti reklamuese dhe ankandesh që merren me shitje të produkteve.

Përjashtim nga këto janë përmbajtjet që kontribuojnë në diskutim të vazhdueshëm.
- 1.5. Gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së komentit për publikim duhet kujdesur që e drejta e privatësisë të jetë në përpjesëtim me rëndësinë e funksionit publik që ushtron personi.
- 1.6. Nuk lejohet përsëritja e shpeshtë e komenteve me përmbajtje të njëjtë ose të ngjashme.

¹ Rekomandimi i Përgjithshëm i Politikave nr. 15 për Luftimin e gjuhës së urrejtjes, 2015, Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Mosdurimit, ECRI përkufizon gjuhën e urrejtjes si: "(...) thirrja, promovimi ose nxitja, në çfarëdo formë e përlules, urrejtjes ose përgojimit të një personi ose grupi të personave, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotipizim negativ, stigmatizim ose kërcënim në lidhje me një person apo grup personash dhe arsyetimin e të gjitha llojeve të mësipërme të shprehjes, në bazë të "racës", ngjyrës, prejardhjes, origjinës kombëtare ose etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë ose besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual".)

² Format e ndryshme të sjelljes së paligjshme dhe të paautorizuar të kryer përmes kompjuterit dhe që i referohen: mashtrimeve kompjuterike; mashtrimeve financiar, falsifikimit dhe keqpërdorimit; mashtrimeve me mallra; falsifikimit të të dhënave dhe dokumenteve; vandalizmit; sabotimit, hakimit dhe spyerit kompjuterik (përshtatur nga Konventa për Krime Kibernetike, 2001).

2 Llojet e moderimit

- 2.1. Para moderimi – media e cila përcaktohet për këtë lloj moderimi merr përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e komentit të publikuar.
- 2.2. Post moderimi - mediat të cilat përcaktohen për këtë lloj të moderimit kanë obligim që pasi të jetë njoftuar ose paralajmëruar („notice and take down“) brenda një afati kohor të arsyeshëm të shqyrtojnë fshirjen e komentit problematik. Nëse nuk veprojnë kështu, do të jenë përgjegjëse për përmbajtjen e komentit.
- 2.3. Moderimi hibrid – paraqet kombinim të para dhe post moderimit për komente të temave jashtëzakonisht të ndjeshme.
- 2.4. Portaleve u rekomandohet të shqyrtojnë mundësinë e mbylljes së opsionit për komentim të temave jashtëzakonisht të ndjeshme.
- 2.5. Portaleve u rekomandohet që komentet ose të publikohen në tërësi ose të mos publikohen fare.

3 Procedurat

3.1 Regjistrimi

Portalet që përcaktohen për post moderim kanë obligim të regjistrojnë përdoruesit.

Për regjistrim të përdoruesit si minimum duhet të kërkohet emri, mbiemri ose nofka dhe email adresa e vlefshme.

Emri i përdoruesit nuk duhet të përmbaj faqe interneti, ose email adresë, informata kontaktuese, të dhëna personale të dikujt tjetër, sharje ose përmbajtje tjera të dyshimta.

3.2 Automatsko filtriranje

Portalet kanë për obligim të përdorin softuer për filtrim automatik të shprehjeve të papërshtatshme/pahijshme.

Komenti për të cilin iu është tërhequr vërejtja moderatorit me sistemin e filtrimit automatik vendoset në „karantinë“ dhe i nënshtrohet para-moderimit.

3.3 Paraqitja e shkeljeve të rregullave të komentimit online

Formulari për paraqitje të shkeljes së rregullave të komentimit online përmban

- Emrin e plotë – (fakultativ)
- Kontaktin (emailin, telefonin) - e obliguar
- Shkakun e paraqitjes - e obliguar

Komentet që i konsideroni të diskutueshme i paraqitni duke klikuar në kutinë që është pjesë përbërëse e komentit.

Formulari për paraqitje për mospublikim të komentit (te para moderimi)

- Emrin e plotë – (fakultativ)
- Kontaktin (emailin, telefonin)
- Përmbajtjen e komentit të pa publikuar

Formulari për ankimim tek trupi vetërregullues kundër veprimeve të moderatorit

- Emri dhe mbiemri
- Kontakti (emaili, telefoni)
- Shkaku (mospublikimi, publikimi, fshirja, mosfshirja, ndalimi i publikimit të komentit)

4 Sanksionet

4.1. Fshirja e komenteve

Komenti i cili nuk është konform rregullave të komentimit online fshihet.

4.2. Ndalimi i përkohshëm i publikimit të komenteve

Shkelja e shpeshtë e Rregullave të komentimit mund të ketë si pasojë ndalimin e përkohshëm të publikimit të komenteve. Kohëzgjatja e ndalimit të përkohshëm vendoset nga portali sipas rregullave të veta të brendshme.

4.3. Ndalimi i përhershëm i publikimit të komenteve

Shkeljet veçanërisht të rënda të Rregullave të komentimit (shkelja e udhëzimit 1.1.), mund të kenë si pasojë ndalimin e përhershëm të publikimit të komenteve.



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission to Montenegro